



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS**  
**СКУПШТИНА КОСОВА**  
**ASSEMBLY OF KOSOVO**

Legjislacioni -III

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi  
Mbledhja nr. 01-2008  
Prishtinë, me 08 shkurt 2008, ora 11:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N- 225

**PROCESVERBAL**

i mbledhjes së Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi

Në mbledhje morën pjesë: Bahri Hyseni, Adem Salihaj, Ramadan Gashi, Selviqe Halimi, Kolë Berisha, Riza Smaka, Bajram Kosumi, Adem Hajdaraj dhe Dzezair Murati, munguan: Melihate Tërmkolli dhe Branislav Grbiq.

Pjesëmarrësit nga monitorimi.

Ramadan Islami - monitorues i OSBE-së  
Lejla Selimi - - monitoruese e OSBE-së  
Reshit Gashi-NDI

Nga zyra e komisioneve të Kuvendit: Idriz Tahiri, Drita Çarkaxhiu, Behlul Zeka dhe Sulltane Gashi.

Mbledhjen e kryesoi z. Bahri Hyseni , kryetar i Komisionit.

**RENDI I DITËS**

1. Konstituimi i Komisionit,
2. Të ndryshme

**1. Miratimi i rendit të ditës**

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

**1. Konstituimi i Komisionit**

**Bahri Hyseni**- kryetar i Komisionit tha se ky është takimi i parë konstituiv i Komisionit dhe me këtë rast do të diskutohen vetëm këto dy pika.

Ai theksoi se pasi që Komisioni ka pësuar ndryshime nga legjislatura e dytë që ka pasur në përbërje edhe çështjet e barazisë gjinore, peticioneve dhe kërkesa publike. Tani merret me çështjet për legjislacion dhe gjyqësi.

Kryetari konstatoi se ky komision është i përbërë na anëtarët – profesionalë. Përkundër detyrave dhe përgjegjësive që do ti ketë ky komision, do të ofrojë profesionalizëm dhe bashkëpunim të sinqertë.

Pastaj i prezantoi anëtarët e Komisionit, stafin përgjegjës që mbështet Komisionin dhe pjesëmarrësit monitorues nga OSBE-ja, NDI dhe USAID-it.

Zëvendëskryetar i parë është Adem Salihaj, ndërsa zëvendëskryetar i dytë është Branislav Grbiq.

Kryetari për rendin e ditës fjalën ua dha anëtarëve të Komisionit.

**Adem Salihaj**- përshëndet anëtarët e Komisionit duke theksuar se do kemi punë shumë voluminoze, sepse për shqyrtim do të kemi shumë projektligje. Për t'u lehtësuar procedura, duhet të kemi mbështetje adekuatë me strukturë shumë profesionale që të arrijmë punë të suksesshme. .

**Riza Smaka**- përshëndet dhe përgëzon Komisionin për punën kolegjiale.

Ai theksoi, se na pret një punë shumë intensive dhe për të përgatitur dhe për të nxjerrë ligje të mira e të zbatueshme kërkohet angazhim i madh.

Parimisht për metodologjinë e punës mirë është se kur i marrim projektligjet t'i ndajmë sipas afiniteteve, të punojmë me përkushtim të madh pa akomodim, që në fund para Komisionit të dalim me një raport sa më profesional.

Sa i përket planit të punës, duhet të krijohen kushtet për punë serioze. Ju si kryetar, duhet së bashku me dy zëvendëskryetarët, që kërkesat tona siç janë: sigurimi i një salle pune, një laptopi, t'i inicioni në instancën më të larta në mënyrë që çështjet teknike të mos jenë pengesë për punë.

Sa u përket ftesave për mbledhje, ai propozoi që ato të bëhen edhe përmes telefonit.

## 2. Të ndryshme

**Bahri Hyseni** - theksoi se do te flasim për çështjet teknike, përmbajtjesore, rreth organizimit të dëgjimeve publike dhe për mbështetjen nga stafi ndërkombëtar.

Ai theksoi, se kushtet për punë janë të pavolitshme, siç janë mungesa e pajisjeve teknike, mungesa e sallave, posaçërisht në rastet kur ftojme ekspertë të fushave të ndryshme. Gjithashtu edhe zyrtarët ligjorë nuk kanë kushte adekuatë për punë. Do të kërkojmë kushte më të volitshme që puna të rrjedh sa më mire.

Për sa u përket çështjeve përmbajtjesore është e nevojshme që të hartohet rregullorja e brendshme e punës e cila do ju shërbejë të gjitha komisioneve. Për këtë kohë do ta respektojmë rregulloren e punës së Kuvendit.

Në shumë raste do të jemi hartues të ligjeve, ndërsa për ligjet tjera do të japim bazën juridike.

Për këtë, në çdo projektligj do të caktojmë një anëtar nga Komisioni, si raportues.

Pastaj ai propozoi, që në mbledhjen e radhës të formojmë dy grupe punuese. Njëri grup do të hartojë planin e përkohshëm për zhvillimin e punës në Komision.

Ndërsa në grupin e dytë do të formojmë nënkomisione, që do të shqyrtojnë ligjet që kanë ardhur nga Qeveria dhe ligjet e pakos së Ahtisarit dhe për çështje të tjera, siç është projektligji për çështje kontestimore që në përbërje ka 500 nene, e për të cilin nevojitet punë me përkushtim të madh.

Ai shtoi se për Ligjet që dalin nga pakoja e Ahtisarit, do ti procedojmë sipas qëndrimit që do të marrë Kryesia.

Pastaj propozoi se do të organizojmë vizita dhe tryeza te rrumbullakëta.

Një ndër objektivat është monitorimi i legjislacionit, për shumë arsye, siç janë: çështjet buxhetore, strukturimi i brendshëm i Qeverisë, pastaj shumë ligje që janë miratuar në Kuvend e të cilat kanë mbetur të pa zbatueshme.

**Adem Hajdaraj** - Sa u përket, organizimit të mbledhjeve dhe ftesave për takime të ndryshme, duhet të përdoren adresat elektronike dhe njëkohësisht të njoftohen me telefon.

Kur është fjala për planin e punës, duhet të kihet parasysh që secili nga anëtarët të caktohen në dy apo më shumë komisione. Për këtë arsye duhet të bëhet koordinimi me të gjithë kryetarët e komisioneve dhe të caktohen ditët dhe orët e mbledhjeve.

**Bajram Kosumi** - Së pari, i përshëndeti kolegët dhe u uroi punë të mbarë. Ai theksoi se gjatë shqyrtimit të ligjeve nuk do të ndalemi në gabimet drejtshkrimore të cilat do marrin shumë kohë. Për këtë arsye ne do të kujdesemi që ligjet të jenë në përputhje me Kornizën Kushtetuese dhe në harmoni me ligjet e tjera të miratuara në Kuvend.

Për planin e punës, do të orientohemi në ligjet që i procedon Qeveria dhe ato që kanë më shumë prioritet. Ai shtoi se plani i punës, u mbetet kryetarit dhe dy zëvendëskryetarëve ta përpilojnë një plan të punës, pastaj bashkarish në Komision ta miratojmë.

Sa i përket organizimit të mbledhjeve materiali duhet të dorëzohet në kuti postare dhe të njoftohemi me telefon.

**Selviqe Halimi** - Ajo theksoi se në legjislaturën e kaluar ka qenë anëtare e dy komisioneve dhe se ka vërejtur se është bërë shumë pak punë profesionale. Më tutje ajo theksoi se deputetët nuk i lexojnë ligjet sa duhet.

Ka nevojë për një bashkëpunim të ngushtë me të gjitha komisionet e tjera dhe se duhet të marremi më tepër me përmbajtjen e ligjeve, e jo vetëm me përputhjen e tyre, sipas Kornizës Kushtetuese.

Ajo u shpreh se komunikimi duhet të bëhet nëpërmjet postës elektronike dhe postës së deputetëve. Ndërsa sa i përket orarit të mbledhjeve, ajo propozoi që mbledhjet të mbahen ditën e parë apo të dytë të javës. Në fund ajo theksoi se e përkrahë idenë që të punohet në grupe të vogla punue.

**Džezair Murati** - Pasi i përshëndeti të pranishmit, theksoi se puna në këtë komision do të jetë dinamike, duke pasur parasysh gjendjen në të cilën jemi.

Ai propozoi të caktohet një datë në lidhje me mbajtjen e mbledhjeve dhe gjithashtu të njoftohen komisionet tjera, në mënyrë që ti shmangemi kolizionit me oraret e tyre. Në fund, ai theksoi se kjo ditë duhet të jetë fillimi i javës por assesi të mos jetë dita e enjte apo e premte.

**Bahri Hyseni** - Përveç përputhshmërisë së projektligjeve me Kornizën Kushtetuese, do të shqyrtojmë ligjet edhe nen për nen, sepse si komision funksional do të jemi edhe raportues në shumë ligje. Gjithashtu do t'i plotësojmë edhe kushtet e punës së bashku me Komisionin për Buxhet dhe Financa.

Ai, mori nismën dhe lexoi ligjet, për të cilat do ti shqyrtojmë si komision funksional.

Ligji për tokën ndërtimore, privatizimin dhe dhënien me qira të tokës ndërtimore, Ligji për Noterinë, Ligji për procedurën jokontestimore, Ligji për procedurën kontestimore, Ligji për procedurën përmbartuese, Ligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit mbi ekzekutimin e sanksioneve penale, i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2004/46, të datës 19 nëntor 2004.

Më tutje theksoi se çështjet teknike nuk do të jenë problem. Ftesat dhe materialet do të bëhen nëpërmes postës elektronike, postës së deputetëve dhe informimit me telefona. Gjithashtu do të njoftohen edhe organizatat që mbështesin komisionin.

Ai konstatoi se do të caktohet një ditë për mbajtjen e mbledhjeve, në fillim ajo ditë do të jetë dita e martë, në orën 11:00.

**Mbledhja përfundoi në orën 12:15.**

Kryetari i Komisionit,

---

Bahri Hyseni

Procesmbajtësja  
Drita Çarkaxhiu